



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 5876 prot.

Tiranë, më 11 .10 .2018

UDHËZIM

Nr. 713 datë 11.10. 2018

PËR

TARIFAT E LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE, TË CILËT PËRDORIN BURIME
TË RREZATIMIT JONIZUES

Në zbatim të nenit 7 gërma "a" e Ligjit Nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar dhe në kuadrin e rishikimit të tarifave të licencimit dhe lejeve duke i përafruar ato me koston, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet,

UDHËZON:

1. Të gjithë personat juridikë dhe fizikë të cilët ushtrojnë veprimtari sipas nenit 3, të Ligjit Nr. 8025 datë 9.11.1995, "Për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese", i ndryshuar, duhet të paguajnë tarifat e mëposhtme për procesin e licensimit dhe lëshimit të aprovimeve përkatëse për import eksport dhe transport të burimeve të rrezatimit jonizues si më poshtë vijon:

- | | |
|--|--------------|
| a. Qendër që përdor burime radioaktive të Kategorisë 1 dhe 2 | 25 mijë Lekë |
| b. Qendër e Mjekësisë Bërthamore | 25 mijë Lekë |
| c. Laborator me përdorim Ria | 10 mijë Lekë |
| d. Qendër që përdor aparaturë Rëntgeni (Grafë, Skopi, Tomografi, mamografi, koronografi, densitometër, angiografi etj) | 15 mijë Lekë |
| e. Qendër që përdor aparaturë Grafë industriale me rreze X/ aparatë me rreze X për terapi | 20 mijë Lekë |
| f. Qendër që përdor Akselerator Linear | 25 mijë Lekë |
| g. Qendër që përdor Tomografi e Kompjuterizuar | 25 mijë Lekë |
| h. Qendër që përdor Skanera të sigurisë | 15 mijë Lekë |
| i. Qendër që përdor aparaturë radiologjike dentare (grafë dentare intraorale, panorameks etj) | 5 mijë Lekë |

- | | |
|---|--------------|
| j. Qendër që përdor burime radioaktive të mbyllura
Kategori 3, 4, 5. | 20 mijë Lekë |
| k. Njësi Transporti Materialesh Radioaktive. | 15 mijë Lekë |
| l. Qendër për trajtimin e Mbetjeve radioaktive, Kategoria nga
1 deri në 5. | 25 mijë Lekë |
| m. Qendër për ruajtjen e përkohshme të burimeve radioaktive
kategoria 2 deri në 5. | 25 mijë Lekë |
| n. Aktivitet në fushën e Arsimit dhe Shkencës. | 10 mijë Lekë |
| o. Licencë import - eksporti për burime të rrezatimit jonizues | 20 mijë Lekë |
| p. Licencë për Instalim dhe/ose mirëmbajtje të gjeneratorëve
ne reze X. | 20 mijë Lekë |
| q. Aprovim import - eksporti për burimet radioaktive
Kategori 3,4, 5, si dhe gjeneratorë me reze x | 1 mijë Lekë |
| r. Aprovim import- eksporti për burimet radioaktive
Kategori 1 dhe 2 | 20 mijë Lekë |
| s. Aprovim transporti për burimet radioaktive Kategori 1 dhe 2 | 5 mijë Lekë |
| t. Aprovim transporti për burimet radioaktive Kategori 3,4 dhe 5 | 2 mijë Lekë |

2. Udhëzimi Nr.675, datë 5.12.2008 “Për tarifatat e licencimit të veprimtarive, të cilët përdorin burime të rrezatimit jonizues” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

